



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË  
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË  
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d), nenit 17, pika (f), nenit 40 paragrafi 2, pika (a) dhe (l), të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 6, të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012”, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-009, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2015”, e konform nenit 4, lidhur me neni 5, të Rregullores Nr. 02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 19/2015 të datës 23.12.2015, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur me datën, 30.03.2022 miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

- 1.1 **MIRATOHET**- nisma e Kryetarit të Komunës së Suharekës për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale “**Eko-Theranda**” SH.A e organizuar si shoqëri aksionare, sipas Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 9/2018”.
- 1.2 Selia e Ndërmarrjes Publike Lokale “**Eko-Theranda**” SH.A është në rrugën “Brigada 123” në qytetin e Suharekës.

### Neni 2

**AUTORIZOHET**, Kryetari i Komunës që të fillon procedurat ligjore për plotësimin e kushteve dhe kriterëve ashtu si që kërkohet me dispozitat e Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-009, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2015” dhe të Rregullores Nr. 02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 19/2015 të datës 23.12.2015, për krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale.

### Neni 3


**OBLIGOHET**- Kryetari i Komunës që të procedoj kërkesën në Ministrin e Ekonomisë me dokumentacionin përkatës sipas dispozitave ligjore të Rregullores Nr. 02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 19/2015 të datës 23.12.2015 dhe pas autorizimit me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të mundësoj funksionalizimin e Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Theranda” Sh.A. me seli në Rr.- “Brigada 123” në qytetin e Suharekës.

### Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 01-016-18419  
Me datë 30.03.2022



Kryesuesi i Kuvendit  
Mr./ec Bexhet KUÇI